



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ERNITA A. HAXHIU
ADRESA KAJO KARAFILI,
PALL."MC INERIE"
TEL:

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 1935

Nr. koleksioni: 1181

Tirane më 13/10/2021

CHECKED
U.B.A.
Agjencia Bulevard

CERTIFIED TRUE COPY
FROM THE ORIGINAL
U.B.A. Agjencia Bulevard

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



A2021050660129258670



Zyra e Përlës
U Pajua



A2021050660129258670

KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI
(TË SHOQËRISË "Fat & Proalb" SH.P.K)

Sot, më datë 13/10/2021, para meje Notere ERNITA A. HAXHIU, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, KAJO KARAFILI, PALL."MC INERIE", u paraqit personalisht:

SHITËSI: **Z.Erjon Kasmi**, atesia Ylli, lindur në Krujë me datë 06.07.1983, e banues në Tiranë, në adresën Kodra e Diellit, Farke, Selite, madhor me zotësi te plotë për të vepruar, mbajtës i pashaportës Nr. BC6694332 dhe nr. personal I30706106B.

BLERËSI: **Z.Redinal Muskaj**, atesia Hamza, lindur në Fier me datë 11.05.1991, banues në Tirane, madhor me zotësi te plotë për të vepruar, mbajtës i pasaportes me nr. personal J10511063I.

NENI 1

- 1.1 Shitësi është ortak i një kuote të barabartë me 50% të vlerës së kapitalit themeltar të shoqërisë "Fat & Proalb" sh.p.k. me NUIS M07523801F dhe seli në Fier Ballsh, Rruga Ballsh-Aranitas, Zona Kadastrale 3192, Nr Pasurie 83/5.
- 1.2 Blerësi dëshiron dhe kërkon të blejë kuotën e zotëruar nga Z. Erjon Kasmi në shoqërinë Fat & Proalb shpk. Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë dhe ortakut tjetër i shoqërisë Z. Ervis Kau kanë rënë dakord për shitjen e kuotës së Z. Erjon Kasmi tek Z. Redinal Muskaj, bazuar në Vendimin e Asamblese bashkalidhur.
- 1.3 Ortaku Ervis Kau në referencë të parashikimeve statutores (neni 9) ka deklaruar edhe nëpërmjet vendimit të asamblesë se është njoftuar për shitjen e kuotës së Z. Erjon Kasmi dhe për cmimin e shitjes, dhe jep dakordësinë për tjetërsimin e kuotës së Z. Kasmi.

NENI 2

- 2.1 Çmimi i shitjes të kuotës në pronësi të Shitësit, e cila përfaqëson 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë "Fat & Proalb sh.p.k", dhe që i kalon blerësit Z. Redinal Muskaj është në vlerën **160,000 (njëqind e gjashtedhjetë mijë) Euro**.
- 2.2 Pagesa e cmimit do të kryhet brenda 60 ditëve nga nënshkrimi i kësaj kontrate në llogarinë bankare që shitësi i ka komunikuar blerësit.
- 2.3 Në momentin e kryerjes së pagesës, pjesa e kuotës së blerë si më sipër, kalon në pronësi të Blerësit.
- 2.4 Administratori i shoqërisë me marrjen e konfirmimit të likuidimit të cmimit nga ana e Blerësit (mandati bankar) bën menjëherë regjistrimin e kontratës dhe ndryshimin e ortakërisë së shoqërisë në QKB.

NENI 3

- 3.1 Me shitjen sa dhe si më sipër të kuotës dhe likuidimin e plotë të cmimit, përbërja e ortakëve në shoqërinë Fat & Proalb shpk ndryshon dhe bëhet si më poshtë:

Ervis Kau

Redinal Muskaj

zotëron 1 kuotë e cila përfaqëson 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

zotëron 1 kuotë e cila përfaqëson 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.



A2021050660129258670

- 3.2 Me realizimin e kësaj shitblerje të kuotës së shoqërisë Fat & Proalb sh.p.k., Blerësit i transferohen të gjitha të drejtat dhe detyrimet ligjore e statutore që rrjedhin nga zotërimi i kuotës.

NENI 4

- 4.1 Shitësi deklaron se është pronar me të drejta të plota mbi pjesët e kuotës që i transferon Blerësit; nuk ka lidhur asnjë kontratë dhe asnjë lloj marrëveshje mbi pronësinë e saj apo që t'i ketë njohur të tretëve të drejta të çfarëdo lloji mbi të deri në datën e sotme; ia shet këto kuota të kapitalit të shoqërisë Blerësit të lira nga çdo detyrim, barrë apo pretendim nga të tretë; të drejtat mbi to, nuk janë të përfshira në procese civile, penale, administrative, arbitrazhi apo të çfarëdo lloji natyre tjetër që të mund të jetë shkak për cënimin e kontratës apo titullin e pronësisë së Blerësit mbi to.
- 4.2 Shitësi deklaron e garanton se (i)nënshkrimi, dorëzimi, e zbatimi i kësaj kontrate është i lejuar nga statuti i shoqërisë dhe asambleja e përgjithshme, (ii)Shitësi ka nënshkruar dhe paguar rregullisht kuotat e tij, (iii)kuotat e transferueshme këtu nuk janë objekt i asnjë kontrate pengu ose ndonjë pretendimi tjetër ligjor të palëve të treta, (iv) kjo kontratë përbën detyrim ligjor, të vlefshëm dhe detyrues dhe të zbatueshëm për Shitësin.
- 4.3 Blerësi deklaron dhe garanton se: (i) kjo Kontratë përbën një detyrim ligjor të vlefshëm dhe detyrues për Blerësin.
- 4.4 Bashkëshortja e z. Erjon Kasmi, znj. Laura Leka , nëpërmjet nënshkrimit të kësaj kontrate jep pëlqimin dhe dakordësinë e saj për kalimin e kuotës së bashkëshortit të saj z. Erjon Kasmi në favor të blerësit z. Redinal Muskaj.

NENI 5

- 5.1 Shitësi deklaron se përpara shitjes së kuotës së tij, ka njoftuar rregullisht ortakun Ervis Kau i cili ka deklaruar se nuk është i interesuar për blerjen e kuotës dhe së në përputhje me nenin 9 të Statutit të shoqërisë ka dhënë pëlqimin e tij edhe në vendimin përkatës të asamblesë për tjetërsimin e kuotës së z. Erjon Kasmi tek z. Redinal Muskaj.

NENI 6

- 6.1 Palët deklarojnë se do të zbatojnë rigorozisht të gjitha të drejtat e detyrimet e tyre që rrjedhin nga kjo kontratë.
- 6.2 Në rast të mospërbushjes së detyrimeve të marra përsipër nga palët kjo kontratë mund të zgjidhet nga secila palë duke njoftuar paraprakisht palët e tjera.
- 6.3 Bashkëlidhur kontratës është dhe vendimi i asamblesë së përgjithshme të shoqërisë Fat & Proalb shpk që lejon shitjen e kuotës së z. Erjon Kasmi.
- 6.4 Kontrata mund të ndryshohet apo revokohet vetëm me marrëveshje me shkrim të palëve.
- 6.5 Njoftimet për palët do të bëhen në rrugë postare në adresat e tyre respektive të dhëna në këtë kontratë.



A2021050660129258670

6.6 Në rast mosmarrëveshje midis tyre në zbatim të kësaj kontrate, palët do të bëjnë të gjitha përpjekjet për zgjidhjen e tyre me mirëkuptim. Në rast se nuk do të arrijnë në zgjidhje me mirëkuptim, kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kjo kontratë hartohet në 4 ekzemplar me të njëjtën vlerë ligjore dhe administratori i shoqërisë, autorizohet të ndjek procedurat e regjistrimit të saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, pas likuidimit të cmimit nga Blerësi.

NË DËSHMI TË SA MË SIPËR, Unë Noteri Publik, pasi ua lexova qartë dhe me zë të lartë gjithcka më sipër palëve, më deklaruan se e kuptuan Kontratën dhe e gjejnë në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, e nënshkruajnë atë përpara meje noterit.

Nënshkruar dhe vulosur dhe prej meje noterit, në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë .

PALET KONTRAKTORE

SHITËSI

Erjon Kasmi


Erjon Kasmi


BLERËSI

Redinal Muskaj

Redinal Muskaj


NOTERE ERNITA HAXHIU

Ernita Haxhiu


EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	M07523801F
2. Data e Regjistrimit	23/01/2020
3. Emri i Subjektit	Fat & Proalb
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	06/01/2020
6. Kohëzgjatja	Nga: 06/01/2020
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Fier Ballsh BALLSH Rruga Ballsh-Aranitas, Zona Kadastrale 3192, Nr Pasurie 83/5
8. Kapitali	100.000,00
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	2,00
9. Objekti i aktivitetit	Import-eksport, tregtim me shumicë dhe pakicë të artikujve industrial, lëkur, tekstile dhe prodhime të tyre. Prodhim dhe tregtim me shumicë e pakicë, këpucësh, faqe këpucësh, për llogari të vet dhe për të tretë. Tregtimi dhe përpunimi i veshjeve dhe rrobave të punës, për vete dhe për të tretë (fasoneri), si dhe blerje - shitje të makinerive të përpunimit e prodhimit të lëkurës, pëlhurës dhe të tekstileve. Transport brenda vendit dhe ndërkombëtar për vete dhe të tretë. Prerje, qepje e prodhim të këpucëve, çantave, rrypave apo veshjeve të lëkurës. Tregëti me shumicë dhe me pakicë edhe on-line , prodhimin , importimin dhe eksportimin , shpërndarjen me dhe/ose pa magazinë , si kombëtare dhe ndërkombëtare, edhe me marrjen e mandateve të perfaqësisë me dhe/ose pa magazinë, te artikujve ushqimore, të veshmbathjeve të cfarëdo lloj përbërje dhe vlere, përfshirë bluze dhe këmbisleri të jashtme, aksesore për veshje të cfarëdo lloj materiali, këpucë, veshmbathje lëkure, copa të cfarëdo lloj materiali, fije dhe aksesore rrobaqepësie, paisje dhe artikuj sportive, parfume, kosmetike, bizhuteri, artikuj për dhurata, kancelari, produkte tekstile të cfarëdo lloji dhe materiali përfshirë ato të arredimit të shtëpive dhe per kujdesin e higjenën personale apo të kafshëve. Shoqëria mundet gjithashtu të përftojë dhe marri shpërndarjen me franchising, pra të ketë të drejtë të shpërndajë markat e saj eventuale dhe dijen dhe eksperiencën e saj (knoë-hoë) në franchising, të bëjë cfarëdo lloj aktiviteti

	të përshtatshëm dhe të lidhur me çfarë është përmendur me lart brenda limiteve ligjore. Mundet të blejë ose marrë me qera dhe mund të marrë përsipër në mënyrë direkte ose indirekte interesat dhe pjesmarrjet në shoqëri të tjera me objekt të ngjashëm.	
10. Administratori/ët	Ervis Kau	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 06/01/2020	Deri: 10/01/2022
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	ErvisKau	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 50.000,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	1,00	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	50,00	
<i>- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)</i>		
13. Ortakët	ErjonKasmi	
13.1 Vlera e kapitalit	Para: 50.000,00	Natyre:
13.2 Numri i pjesëve	1,00	
13.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	50,00	
<i>- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)</i>		
14. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit		
15. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: Fat & Proalb E-Mail: fat.proalb.shkp@gmail.com Telefon: 0692989827	
16. Statusi:	Aktiv	

Datë: 13/10/2021

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)

REZULTATET E KËRKIMIT

Numri i Rezultatit të Kerkimit:	D-202110139332288
Data e Rezultatit të Kerkimit:	13.10.2021
Ora e Rezultatit të Kerkimit:	9:33:02AM
Lloji i Kerkimit:	
Numri i Dokumentit:	D-400-498-446
Referenca e Përdoruesit:	

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KËRKIMI 0

ERJON YLLI KASMI
FAT & PROALB SH.P.K.



Florida Dard